

VENDIM
Nr. 738, datë 3.12.2021

**PËR MIRATIMIN E GARANCIVE SHTETËRORE, NË FAVOR TË RAIFFEISEN
BANK SHA, PËR KONTRATAT E KREDISË NDËRMJET RAIFFEISEN BANK
SHA DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SHA,
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE)
GROUP SHA, FURNIZUESIT TË TREGUT TË LIRË (FTL) SHA, OPERATORIT
TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA, PËR FINANCIMIN E
KAPITALIT PUNUES NË KUADËR TË NEVOJAVE PËR IMPORT TË
ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Raiffeisen Bank sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Raiffeisen Bank sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a., Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., për financimin e kapitalit punues në kuadër të nevojave për import të energjisë, në shumën 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro.

2. Miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Raiffeisen Bank, sh.a., për kontratën e kredisë, ndërmjet Raiffeisen Bank sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a., Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për financimin e kapitalit punues në kuadër të nevojave për import të energjisë, në shumën 16 500 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) euro.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe OSHEE Group sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj